

AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI I SHOQËRISË “VORTEX SOLUTION FX” SHPK

THEMELIMI

Neni 1
Ortaket themelues

- 1.1 Shoqëria “VORTEX SOLUTION FX” SH.P.K. themelohet nga Ortaket:
Z.Francesco Nicoletti, shtetas italian, lindur më 23.07.1989 ne San Giovanni in Fiore (CZ), Itali, rezident ne Arezzo (AR), Itali, mbajtes i Pasaportes me Nr. YB2208214 me zotesi te plote per te vepruar;
Z.Federico Paggini, shtetas italian, lindur më 27.01.1990 ne Arezzo (AR), Itali, rezident ne Capolona (AR), Itali, mbajtes i Pasaportes me Nr. YA4684604 me zotesi te plote per te vepruar;

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është “VORTEX SOLUTION FX” SH.P.K.

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).
5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Brigada VIII, Ndertesa nr.23, Hyrja nr.4, 1019, Tirane
6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 7
Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

Dhenia me qera, përmes faqes së internetit, të një software të automatizuar nëpërmjet tarifës së një abonimi mujor. Menaxhimi dhe administrimi i softwareve dhe aplikacioneve të prodhuara për llogari të shoqërisë. Përgatitja dhe mirëmbajtja e aplikacioneve të ndryshme. Menaxhimi i qendrave të përpunimit të të dhënave dhe të rrjeteve elektronike të çdo lloji. Shoqëria mund të punësojë dhe pranojë agjenci, komisione, përfaqësim dhe mandatim.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 9

Kapitali

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (Njëqind mijë ALL).

9.2 Kapitali ndahet në 2 (dy) pjesë.

Z.Francesco Nicoletti, zotëues i një kuote me vlerë të përgjithshme 70000 ALL që përben 70% të kapitalit

Z.Federico Paggini, zotëues i një kuote me vlerë të përgjithshme 30000 ALL që përben 30% të kapitalit

9.3 Pjesa e kapitalit zotërohet 100% nga Ortaket.

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

10.2 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet përkatëse.

10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 11

Rritja e kapitalit

11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit

12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Ortakeve të shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Ortakeve raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e Asamblese se Ortakeve

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Ortakeve.

13.2 Vendimet e Asamblese se Ortakeve përfshijnë kryesisht:

- Ndryshimin e selisë ose të emërimit të shoqërisë;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera.

Neni 14

Administrimi

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblese se ortakeve.

14.3 Administratori i shoqërisë është *Z. Roberto Mazzuca, shtetas italian, lindur më 11.03.1990 ne Cosenza (CZ), Itali, rezident ne Cosenza (CZ), Itali, mbajtes i Kartes ID me Nr. YA5657433 me zotesi te plote per te vepruar*

14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
 - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri apo kudo jashte saj tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private,
 - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
 - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar,
 - Të hape dege ose zyre perfaqesimi, qe konsiderohen te nevojshëm për biznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 15

Viti financiar

15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaket dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Ortakeve.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likuidimi

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

18.2 Me vendimin e Asamblese se Ortakeve caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.

18.3 Likujdatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Ortakeve do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 18.01.2021

ORTAKET:

Z. Francesco Nicoletti

Z. Federico Paggini

